

Hetimi dhe marrja në pyetje e të ashtuquajturve armiq të popullit – roli dhe funksioni i hetuesit

Skënder Vrioni

Grupi i punës: Edlir Orhani, Elisabeta Gripshi, Gerla Kotka, Elton Kryemadhi

[BIO \(Skënder Vrioni\)](#)

Abstrakt

Ky studim analizon rolin dhe funksionet e hetuesit brenda strukturave të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri gjatë periudhës 1945–1991, duke e trajtuar atë jo thjesht si një zbatues formal të ligjit penal, por si një hallkë të rëndësishme institucionale të sistemit shtetëror të kohës. Nga shqyrtimi i literaturës dedikuar pushtetin totalitar, rezulton se aparati hetues nuk ishte thjesht një njësi e vogël e sistemit, apo një zgjatim i pushtetit të prokurorit, por një hallkë kyçe që mbështeste dhe forconte dominimin ideologjik, si dhe funksionimin e strukturave gjyqësore, përfshirë gjykatat dhe prokurorinë. Rastet e përdorimit të dhunës dhe manipulimit të dëshmive tregojnë se procesi hetimor ishte shndërruar në një instrument i sofistikuar intimidimi dhe terrori psikologjik, duke krijuar një klimë të vazhdueshme frike dhe nënshtrimi ndaj atyre që shpallehin “*armiq të pushteti*”.

Për të nxjerrë në pah këto fenomene dhe për të kuptuar mënyrën se si hetuesia kontribuonte në ruajtjen dhe ushtrimin e pushtetit totalitar, studimi përdor një metodologji të kombinuar dhe të integruar, e cila përfshin analizën e burimeve arkivore dhe shqyrtimin e dosjeve procedurale, krahasimin historik të praktikave operative, mbledhjen e dëshmive nga të burgosur politikë apo nga të afërmit e tyre, si dhe analizën e romaneve dhe veprave memuaristike që trajtojnë këtë tematikë. Përmes kësaj metode hulumtuese synohet të evidentohen jo vetëm trajektoret e zhvillimit të hetuesisë, por edhe metodat antiligjore të përdorura prej saj gjatë proceseve hetimore, si dhe pasojat e tyre afatgjata mbi shoqërinë shqiptare, të demonstruara përmes rasteve konkrete. Pra, në thelb, analiza ofron një panoramë tërësore të funksionimit të këtij organi dhe të ndërveprimeve të tij me institucionet e tjera, duke evidentuar format e keqshfrytëzimit institucional pa adoptuar një qëndrim përfundimtar apo gjykues dhe duke krijuar bazën për interpretime të mëtejshme shkencore në studime të ardhshme. Gjithashtu, studimi respekton standardet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e anonimatit, në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr. 124/2024 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” dhe Ligjin nr. 45/2015 “*Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit*”.

Fjalë kyçe: *hetues, hetuesi, prokuror, armiq të pushteti, ligji penal, manipulim dëshmish.*